



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI KOMBETAR I UJIT
KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES "VJOSE" VLORE

VENDIM
Nr. 13, Data 17.10.2011

Per mos miratimin e kerkeses per marrje Leje, per perdorim te rezerves ujore, prej burimeve ujore te lumit Ftere, per prodhim te energjise elektrike, nepermjet HEC-ve "Fterra" dhe "Fterra I", prej subjektit "Hydroborsh" sh.p.k. me Administrator Z.Fatmir Hoxha, Tirane

Ne plotesim te kerkeses te bere prej subjektit "Hydroborsh" sh.p.k dhe ne zbatim te kerkesave te Ligjit Nr.8093, Dt.21.03.1996 "Per Rezervat Ujore", te ligjit nr. 9663, dt. 18.12.2006 per koncesionet, vendimit te K.M nr. 27, dt. 19.01.2007 "Per miratimin e rregullave te vleresimit dhe dhenies te koncesioneve", vendimit nr.3. dt.19.07.2002 te K.K.U-se "Per miratimin e rregullores te sekretariatit teknik te K.K.U, te K.B.U dhe te A.U, udhezimit te M.M.P.A.U dhe M.E.T.E. vendimit nr. 476, dt. 06.05.2009 te K.M, "Per miratimin e kontrates koncesionare te formes Rot", vendimit nr.8 Dt.20.01.2009 Te K.B.U "Vjose" per dhenien te vendimit "Miratim ne parim per dhenie te lejes per shfrytezimin te burimeve ujore per prodhim te energjie nepermjet HEC qe parashikohen te ndertohen, dhene ky vendim shoqerise "Hydro Valbonc", si dhe duke marre ne konsiderate kerkesen e shoqerise "Hydroborsh" sh.p.k, si dhe marreveshjen e dt. 31.08.2009 lidhur mes M.E.T.E dhe shoqerise "Hydroborsh" sh.p.k, per ndertimin e e hidrocentraleve "Fterra" dhe "Fterra I", si dhe faktin qe subjektit te mesiperperm ju miratua leja mjedisore.

K.B.U Vjose:

VENDOSI:

- 1- Mos miratimin e kerkeses te bere nga subjekti "Hydroborsh" sh.p.k per dhenie leje "Per perdorim te rezerves ujore" per prodhim te energjise elektrike, nepermjet HEC-ve "Fterra" dhe "Fterra I", duke perdorur burimin uhor lumin Fterre, Komuna Lukove, Rrethi Sarande, Qarku Vlore, per mos perputhje te te dhenave midis studimit te paraqitur nga vete subjekti me kontraten e koncesionit te lidhur me M.E.T.E si dhe me te dhenat e pasqyruara ne lejen mjedisore.
- 2- Subjekti "Hydroborsh" sh.p.k, duhet te paraqesi dokumentacionin e kerkuar brenda muajit qe vijon nese do te aplikojte per mbledhjen e ardheshme.

Vazhdim i vendimit nr.13, dt. 17.10.2011

3- Ngarkohet A.U.B "Vjose" per zbatimin e ketij vendimi.

4- Ky vendim hyne ne fuqi menjehere.

PERGJEGJES I A.U.B "VJOSE"

Ardian DINE

KRYETARI I K.B.U "VJOSE"

Eduar VELGANI